



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 17 DATË 29/03 / 2024

MBI

**“MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR DHËNIEN ME QIRA ME AFAT 10 VJECAR TË
DISA PARCELAVE KULLOSORE, FOND PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË ”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së R.SH, të Ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” (të ndryshuar), të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.7.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie të tyre për kullotje e kositje bari “ si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.6, 31.1.2024 ‘ Mbi miratimin e listës së parcelave kullosore verore / dimërore që do të kontraktohen për përdorimin me qira për kullotje për sezonin veror 2024 dhe sezonin dimëror 2024 – 2025 “, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e datës 29/03 / 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesat për dhënie me qira me afat 10 vjecar të parcelave kullosore verore sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj

